



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/32

Datë: 03.06.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 15 paragrafi 4 i Ligjit nr. 04/L-036 mbi Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 qershor 2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Plani Vjetor i Statistikave Zyrtare për vitin 2016.
2. Agjencia e Statistikave e Kosovës është e obliguar që pjesën e implikimeve financiare të këtij plani ta harmonizoj me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.
3. Obligohet Agjencia e Statistikave e Kosovës për zbatimin e Planit nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë